



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

P.nr.09/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega Novobërdë-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, në lëndën penale kundër të pandehurit V. Q., nga Gjilani, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi I pasurisë, nga neni 321 paragrafi 1 i Kodit Penal të republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.147/21, të datës 25.01.2021, më datën 27.04.2021 mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

V. (M.) Q., i lindur më 21.05.2001, në Gjilan, me vendbanim në kompleksin banesor “....”ku edhe jeton, me nr. Personal .., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i cili

Është fajtor

Sepse me datë 29.12.2020, rreth orës 00.20 minuta, në hyrje të fshatit Stanishor përballë restorant “Trofta”, në rrugën kryesore që shpie nga fshati Malresh për Gjilan, i pandehuri V. Q., pas një mosmarrveshje të mëhershme me dëshmitaren Rr. Sh., derisa ajo ishte duke lëvizur me veturën e të dëmtuarit A. S.i, të markës Mercedes, me targa të Zvicrës, i pandehuri e godet me grusht dhe ia then xhamin e mbrapëm të kësaj veture, duke e dëmtuar në vlerë të papërcaktuar,

- me këtë ka kryer veprën penale asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 paragrafi 1 i KPRK.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4,7,11,17,21,38,43 të KPRK, si dhe nenit 493e 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit V. A., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 230 € (dyqindetridhjetë euro), të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

I dëmtuari A. S. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit V. Q. , nga Gjilani, për shkak të veprës penale asgjësimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 i KPRK. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit V. Q. dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, deklaratës së të dëmtuarit, fotografive që gjenden në shkresa të lëndës, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri V. Q. nga Gjilani, ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 paragrafi 1 i KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 493 e 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NOVOBERDE

Më 27.04.2022

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Aziziz,**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimet të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.